



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA VAU DEJES**  
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT  
SEKTORI I ASETETEVE

**Projekt – Vendim**  
Nr 09.date 20.02.2023

**Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie me qira të sipërfaqes prej 0.315 ha, pjesë e pasurisë nr 22, Zk nr 1100, e llojit “Kullotë”, në fshatin Barbullush, pronë e Bashkisë Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës të jetë; “Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut”.**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, neni 27 pika 5, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. Në VKM nr. 246 dt 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, datë 28.08.2008 të Këshillit të ministrave, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike të shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, VKM nr 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.”, Udhëzimin nr 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

**VENDOSI :**

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.315 ha, sipas plan rievimit bashkëlidhur, e llojit “Kullotë”, pjesë e pasurisë nr 22, Zk nr 1100, fshati Barbullush, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
3. Vlera dysheme e qirasë vjetore, sipas VKM-së Nr 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.
- 4.

**KRYETARI**  
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETARI**  
**Kristian SHKRELI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT  
SEKTORI I ASETIVE

**RELACION**

**Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie me qira të sipërfaqes prej 0.315 ha, pjesë e pasurisë nr 22, Zk nr 1100, e llojit “Kullotë”, në fshatin Barbullush, pronë e Bashkisë Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës të jetë; “Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut”.**

**Këshillit Bashkiak Vau Dejës**

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullësor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin nr 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika el, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” .

*Sipërfaqja e marrë në studim do të dalë në ankand nëpërmjet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.*

Sipërfaqja që kërkohet të merret në përdorim është **0.315 Ha.**

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas **VKM-së nr. 559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor/kullësor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Shtojca 1, pika 8/4, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit **si më poshtë.**

8. Për mbareshtimin e faunës së egër dhe gjahut.				
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqia e përdorur në Ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit	
			1 vit	2- 5 vjet
1	Kullote	24 000	23 000	20 000

Nga llogaritja e vlerave sipas tabelës më sipër del: Sip 0.315 Ha x 20 000 lek/Ha në vit = 6300 (gjashte mije e treqind) leke/vit.

Për sa më sipër, propozojmë dhënien në përdorim të sipërfaqes së sipërshqyrtuar, ndodhur në fshatin Barbullush, Bashkia Vau Dejës.

Grupi i punës

Mark Suli

Ndoc Baqli

Ilda Prendi

**KRYETARI**  
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETARI**  
**Kristian SHKRELI**



**RAPORT**

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË PRONËSI TË BASHKISË VAU DEJËS, "PËR MBARESHTIMIN E FAUNËS SË EGËR DHE GJAHUT".

Bazuar në Urdhërin **nr.20, datë 26.01.2023**, të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes kullimore për dhënie me qira të fondit kullor, "Grupi i punës i përbërë nga z.Ndoc Baqli, Përgjegjës i sektorit të Aseteve, z. Mark Suli, specialist i administrimit të pyjeve, znj Ilda Prendi specialiste, nga data **13.02.2023** deri në datën **15.02.2023**, realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes kullimore, me objekt dhënien në përdorim të sipërfaqes kullimore prej **0.315** ha, "*Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut*".

Mbështetur në të dhënat e rregjistrit kadastral pyjor/kullor sipas VKM nr.246, datë 31.03.2011, "*Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr 68 date 28.01.2008 të këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës"*,rezulton se sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim është **0.315** ha, pjesë e pasurisë nr 22, Zk nr 1100, fshati Barbullush, në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, me çertifikatë pronësie.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur).*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacion jepen në përdorim me afat deri **10 vjet**, një sipërfaqe prej **0.315 ha** "*Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut*".

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr. 1353,datë 10.10.2008,të ndryshuar "*Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor*", në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar "*Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor*". Udhëzimin e Ministrisë të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 "*Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik*" pika nr 2, germa (a) dhe pika 7.

Sipërfaqja e marrë në studim do`ti nënshtrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi, për dhënien në përdorim të pasurive të llojit kullorë.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, Kryetari i Bashkisë nxjerr urdhërin për përgatitjen e dokumentave të ankandit nëpërmjet procedurës së konkurimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-në nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”,Shtojca 1, pika 8/4, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

**Shuma në lek/vit konsiston në:**

**1. Vlerën dysheme e përdorimit leke/ha/vit për “Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut”**

Pasuria nr 22, Zk nr 1100, me sipërfaqe kullote prej 0.315 ha x 20 000 leke per ha/vit = 6 300 lekë/vit.

#### PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing. Mark Suli

P/sek Ndoc Baqli

Ilda Prendi

**KRYETARI**  
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV/KRYETARI**

**Kristian SHKRELI**

Bashkia Vau Dejës

**TABELA PERMBLEDHËSE E VLËRESIMIT FINANCIAR**

Për mbarëshkrimin e faunës së egër dhe gjahut

**Formulari nr.4**

Perdorimi i territorit	Sipërfaqja	Bashkia	Volumi në m <sup>3</sup> sipas asortimenteve	Sasia	Vlera Leke /m <sup>3</sup>	Shuma I	Gjatesia e perdorimit rrugë ne	Tarifa dhenie ne perdorim lek/ha/vit		Shuma II	Totali I+II
								1	2.-5		
0	1	2	3		4	5	6	8	9	10	12
Pyll	0	V.Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pyll	0	V.Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kullote	0.315	V.Dejës	0	0	0	0	0	24 000	23 000	20 000	6,300
Gjuetia	0	V.Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Invest	0	V.Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsejt</b>	<b>0.315</b>				<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6,300</b>

Bashkia Vau Dejës

**LISTA E NGASTRAVE, N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM**

Për mbarëshkrimin e faunës së egër dhe gjahut

Nr.	ID Prones	Ekonomia Pyjore/kullosore	Ng/neng.nr.	Sipërfaqja e qe jepet ne perdorim hiqet nga fondi	Siperfaqja qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kullosor	Gjatesia ne perdorim km	
						Rruge km	Linje
1	2	3	4	5	6	7	8
1	1100	Barbullush	22	0	0.315	0	0
							9
							0

**PLOTËSOL:**

Ing.Mark Suli

Ndoc-Baqli

Ilda Prendi





Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas regjistrit kadastral)

Për mbarëshkrimin e faunës së egër dhe gjahut

Formulari nr.1

ID.	Ekonomia Pyjore	Parcela	Sip.Tot. ha	Perberja grumbullit	Funksioni	Forma	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
								Qeverisjes	Mosha	D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Kat et
1100	Barbullush	22	0.315	Kullotë	Kullotë	Kullotë	0	0	0	0	0	0	0	0

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas verifikimit ne terren)

Për mbarëshkrimin e faunës së egër dhe gjahut

Formulari nr. 2

ID.	Ekonomia Pyjore	Parcela	Sip.Tot. ha	Perberja grumbullit	Funksioni	Forma	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
								Qeverisjes	Mosha	D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Kat et
1100	Barbullush	22	0.315	Kullotë	Kullotë	Kullotë	0	0	0	0	0	0	0	0

**PLOTESOI:**

Mark Suli



Ndoç Baqli



Hida Prendi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË  
PËR VËRTETIM PRONËSIE

444817

Zyra e Regjistrimit SHKODER Zona Kadastrale Nr. 1100  
 Numri i Pasurisë 22 Volumi 1 Faqe 161  
 Adresa e Pasurisë BARPULLUSA-SHKODER  
 Lloji i Pasurisë KULLOTE  
 Sipërfaqja Totale 13580 m<sup>2</sup> (TREM BE DH JETE MIDE E TËSE QINDE E TË TË DH JETE) m<sup>2</sup>  
 Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>KOMUNA</u>	<u>BUSHAT</u>		<u>1</u>	<u>BUSHAT-SHKODER</u>


- është pronar i PASURISË ME NR. 22
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart -
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi -
- kufizimet e pasurisë janë : V28, 26, 27, 25, 159, 759/1, J 762, P 762

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 09.06.2011 Nr. \_\_\_\_\_

Data e lëshimit të çertifikatës

28.06.2011






# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT  
TE PASURIVE TE PALUAJSHME

SHKODER

ING. G. TERINCIA



Fila

## A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 1100 NR. I PASURISE 22 VOL. I FQ. 161

INDEKSI I HARTES K-34-76-(34-C) SHKALLA 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER Q/ BARBULLUSH

Rr/L \_\_\_\_\_ P/G \_\_\_\_\_ Sh \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ Ap \_\_\_\_\_

## B. KUFIZIMET

V. 28, 26, 27 25, 759

L. 759/1

J. 762

P. 762

## C. PRONARI

KOMUNA BUSHAT

S = 13 580 m<sup>2</sup>

D. Data: 27.10.2011 Ora: \_\_\_\_\_



# PLAN RILEVIM

## PERGATITI

Emri mblemri: Albert MARKOLAJ

Licensa Nr. T - 4900 date 01.02.2008

Data e pergatitjes: 08/ 01 / 2013

NDARJE PASURIE

S1= 3 150m<sup>2</sup> PER DHENIE ME QERA

S2= 10 430m<sup>2</sup>

## IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 1100

NUMRI I PASURISE : 22 VOL. 1 FAQE. 161

INDEKSI I HARTES : K - 34 - 76 - ( 34 - C )

SHKALLA : 1: 2 500

ADRESA E PASURISE: Rrethi: SHKODER

Q/F: BARBULLUSH Rr/L \_\_\_\_\_

P/G: \_\_\_\_\_ Sh \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ Ap \_\_\_\_\_

PRONARI / ET : KOMUNA BUSHAT

